

Fontelis

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



GHS07 GHS09

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Fontelis është një fungicid i ri me spektër të gjerë veprimi për kontrollin e disa sëmundjeve kërpudhore ne peme frutore, perime, vresht dhe bimë dekorative.

Lëndavepruese: 200 g/lit Penthiopyrad.

Formulimi: Koncentrat i suspensueshem (SC)

Masatparambrojtëse:

- P102: Mbajeni larg fëmijëve.
- P103: Lexoni etiketën përpara përdorimit.
- P201: Merrni udhëzime të veçanta përpara përdorimit.
- P202: Mos e trajto deri sa të jenë lexuar dhe kuptuar të gjitha paralajmërimet e sigurisë.
- P281: Perdorni veshje mbrojtëse.
- P391: Mblidheni atë që derdhet.
- P405: Magazinojeni të kyçur.
- P501: Hidheni përmbajtjen/kontejnerin në përputhje me legjislacionin në vend.
- EUH401: Per te evituar rreziqet per njerezit dhe mjedisin, permbajuni udhezimeve te perdorimit ne kete etikete.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast kontakti me lëkurën: Hiqni rrobat e ndotura. Shpëlahuni menjëherë me ujë të bollshëm. Nëse një person nuk ndihet mirë osë ka irritim të lëkurës, konsultohuni me mjekun.
- Në rast kontakti me sytë: Mbani sytë hapur dhe shpëlahuni me kujdes me ujë të bollshëm, edhe nën kapakët e syve, për të paktën 15 min. Konsultohuni me specialistin përkatës për këshilla mbi trajtimin.
- Në rast thithje nëpërmjet frymëmarrjes: Lëvizeni personin në ajër të freskët. Nëse është e nevojshme, jepni oksigjen dhe frymëmarrje gojë-gojë, nëse është e mundur. Konsultohuni me mjekun për këshilla mjekësore të mëtejshme.
- Në rast gjëllitje: Pini 1-2 gota me ujë. Lajmëroni menjëherë mjekun. Mos shkaktoni të vjella, përveç në rast se ju këshillohet nga mjeku. Asnjëherë mos ndikoni vjellje apo të jepni diçka nga goja të sëmurit pa ndjenja ose me konvulsione.
- P308-P313: Në qoftë se ekspozoheni ose shqetësoheni: Menjëherë telefononi një qendër helmimi apo një doktor/mjek. P101: Nëse duhet këshillë mjekësore, mbajeni kontejnerin ose etiketën e produktit afër.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

Përdorimi

Në mollë, dardhë: Për kontrollin e kromës, hirit, alternaries dhe njollosjes kafe te dardhes, me 75 ml/100 lit ujë. Në rast aplikimi deri në fund të lulëzimit, përdorni vëllim solucion 1000-1200 lit/ha (750-900 ml/ha). Mund të kryeni 2 trajtime/sezon, me interval 7 dite.

Në pjeshkë, nektarina, kajsi, kumbull, qersh, ftonj: për kontrollin e kalbëzimit (*Monilia spp.*) dhe hirit gjate fazës së lulëzimit. Kryeni 1 aplikim të vetëm, me 75 ml/100 lit uje; gjatë fazës së zhvillimit dhe maturimit të frutave, kryeni maksimumi 2 aplikime me 1,5 l/ha, në solucion 500-1000 lit ujë. Mund të kryeni 2 trajtime/sezon, me interval 7 dite.

Në hardhi: për kontrollin e hirit, me 75 ml/100 lit ujë, ne 1000-1200 lit/ha (750-900 ml/ha). Mund të kryeni 2 trajtime/sezon, me interval 7 dite.

Domate, patëllxhan: për kontrollin e botritisit dhe sklerotinis: -ne fushë të hapur, me 2,4 lit/ha, në 500-1200 lit ujë; kryeni 1 aplikim/sezon; -ne sera, me 2 lit/ha në 500-1000 lit ujë. Mund të kryeni 2 trajtime/sezon, me interval 5 dite.

Spec (në sera): për kontrollin e botritisit, me 2 lit/ha në 500-1000 lit ujë. Mund të kryeni 2 trajtime/sezon, me interval 5 dite.

Kungullore, kastravec, pjepër, kungull, etj.: për kontrollin e botritisit, hirit dhe sklerotinis: -ne fushë të hapur, me 2,4 lit/ha në 500-1200 lit ujë; kryeni 1 aplikim/sezon; -ne sera, me 2 lit/ha në 500-1000 lit ujë. Mund të kryeni 2 trajtime/sezon, me interval 5 dite.

Perime gjethore (sallatë, spinaq, lakër, rukola, etj.): për kontrollin e botritisit dhe sklerotinis, me 1,5 lit/ha në 200-1000 lit ujë. Kryeni 1 trajtim/sezon.

Lule shtrydhe: për kontrollin e botritisit dhe hirit, me 1,75 lit/ha në 200-1000 lit ujë. Mund të kryeni 2 trajtime/sezon, me interval 5 dite.

Ky produkt mund të përdoret si pjesë e programit IPM. Konsultohuni me shërbimin e ekstensionit ose me profesionistë të zonës suaj për të përcaktuar nivelin e infeksioneve për trajtimin.

Vërejtje për përdorimin:

FRONTELIS është i pajtueshëm me shumë PMB, plehra të lëngshme dhe produkte biologjike. Evitoni përzierjet në serbator përveç se kur rekomandohet në etiketë ose nga ekspertët. Për të shmangur fenomenin e rezistencës, trajtoni sipas rekomandimeve. Mos aplikoni në kushte të këqija moti, në shi, me erë, ose në orët me temperatura të larta. Mos aplikoni me paisje spërkatëse, të cilat nuk funksionojnë mire ose janë të dëmtuara. Duhet përdorur si parandalues, duke trajtuar sapo të shfaqen kushtet e favorshme për zhvelimin e sëmundjeve, duke u kujdesur për të spërkatur të gjithë masën vegjetative. Përdorni vetëm mjete të pershtatshme për spërkatje.

Ndikimi në ekosistem:

Mesatarisht helmues për gjitarët dhe për zogjtë. Pak helmues për bletët. H400: Shumë toksike për organizmat ujorë. H410: Shumë toksike për jetën ujore me efekte të gjata. H412: E dëmshme për jetën ujore me efekte të gjata. SP1: Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij (Mos pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor/shmangni ndotjen përmes kullonjeve nga kopshtet dhe rrugët). SPe3: Për të mbrojtur organizmat ujorë respektoni një zonë tamponësh të patrajtuar prej 10 m në rrjedhjet ujore sipërfaqësore. Mos aplikoni këtë produkt direkt ose pranë një sipërfaqe uji dhe në të gjitha mjediset e tjera ujore si: pellgje, liqene, kanale ujitëse, kulluese, etj. Respektoni distancat për zonat e mbrojtura (min 20 m). P273: Shmangni lëshimin në mjedis.

Karenca:

3 ditë për perimet; 7 ditë për perimet gjethore; 21 ditë në mollë dhe dardhë; 3 ditë për pjeshken, kajsinë dhe nektarinat.

Ruajtja dhe magazinimi:

Të ruhet në kontenierët origjinalë, në vende të thata, të freskëta dhe të ajrosura mirë, në temperatura 1-30°C, larg rrezeve të drejtpërdrejta të diellit dhe lëndëve djegëse. Ka rrezik vetë-ndezje nëse magazinohet në ambiente me lagështirë.

Nr dhe data e regjistrimit: 719, datë 24.4.2020.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 Lit.

Data e prodhimit: *Printuar nga makineria në ambalazh;*

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese: *Printuar në ambalazh;*

Tipi i ambalazhit bazë: COEX ose HDPE.

Aplikanti: Corteva Agriscience International Sàrl. **Adresa:** Versoix, Zvicër;

Fabrikuesi i PMB-së: Corteva Agriscience International Sàrl. **Adresa:** Versoix, Zvicër.